



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:098414
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05721376

K.Dh.Shk.II.nr.599/24

GJYKATA KOMERCIALE – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “F.H.” B.I. (NPN Toning) me NUI 810482563 me seli në rrugën Eduard Lir nr.50 në Prishtinë, i cili përfaqësohet sipas prokurës nga avokati Agron Krasniqi, me seli në rrugën Tirana, objekti Prime Group, hyrja D/8 në Prishtinë, kundër debitorit “Euro Abi” ShPK me NUI 810677338 dhe seli në rrugën Tirana p.nr. në Viti, i cili përfaqësohet sipas prokurës nga zyra ligjore ProJustica me seli në rrugën Rexhep Luci nr.45/2 në Prishtinë, për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm - faturave, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.383/2023, të datës 29.12.2023, me datën 22.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “F.H.” B.I. (NPN Toning) me NUI 810482563 me seli në rrugën Eduard Lir nr.50 në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.383/2023, të datës 29.12.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykat1 Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.383/2023, të datës 29.12.2023, e ka pranuar në tërësi prapësimi i debitorit “Euro Abi” ShPK me NUI 810677338 dhe seli në Viti, anulohet në tërësi urdhri përmbarimor P.nr.28/2023 i datës 10.01.2023 i përmbaruesit privat Bardh Tasholli me seli në Ferizaj dhe përfundohet në tërësi procedura përmbarimore. Ndërsa në piken II të dispozitivit është detyruar kreditorit i përmbarimit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj debitorit të përmbarimit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas

prapësimi të debitorit në shumë të përgjithshme prej 325.00€, në emër të përpilimit të prapësimi nga avokati.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që të aprovohet në tërësi ankesa e kreditorit dhe të anulohet aktvendimi KPPP.nr.383/23 i datës 29.12.2023 për refuzimin e propozimit për përmbarrim të kreditorit, dhe të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit, si dhe të obligohet kreditorit që ti paguaj të gjitha shpenzimet të cilat janë shkaktuar debitorit në procedurën përmbarrimore.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Kreditori "F.H." B.I. (NPN Toning) me NUI 810482563 dhe të dhëna tjera si në hyrje të këtij aktvendimi (këtu e tutje Kreditori) më 10.01.2023 ka parashtruar propozim për përmbarrim (këtu e tutje Propozimi) në zyrën e përmbarruesit privat Bardh Tasholli me seli në Ferizaj (këtu e tutje Përmbarruesi), me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori "Euro Abi" ShPK me NUI 810677338 dhe të dhëna tjera si në hyrje të këtij aktvendimi (këtu e tutje Debitori) që t'ia paguaj shumën prej 656,071.92€ me kamatëvonesë vjetore prej 8% duke llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme deri në pagesë definitive dhe shpenzimet e procedurës faqja 2 nga 4 përmbarrimore. Propozimin për përmbarrim e kishte bazuar në faturën nr. 001-1/2022 të datës 02.11.2022 të lëshuara nga ai për Debitorin, të cilat në origjinal ia ka bashkëngjitur Propozimit. Përmbarruesi më 10.01.2023 e ka nxjerrë urdhrin përmbarrimor P.nr.28/2023 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbarrimin sipas Propozimit.

Debitori më 22.02.2023 ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin dhe i kërkuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin dhe ta anuloj urdhrin. Ai ka pretenduar se fatura e Kreditorit ka të meta substanciale pasi posedon numër tjetër (001- 11/20220), për dallim nga numri i shënuar në propozim për përmbarrim. Shton se fatura e bashkëngjitur nuk është pranuar asnjëherë nga Debitori në mënyrë zyrtare me vulë dhe nënshkrim të Debitorit, në mënyrë që të përmbushet kushti ligjor për rregullsinë e saj dhe të konsiderohet si dokument i besueshëm. Prapësimi nuk ia ka bashkëngjitur asnjë provë, ka kërkuar shpërbllimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e Prapësimi në vlerë prej 325€ sipas tarifës së OAK-së.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi atë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin. Ai ka deklaruar se së bashku me propozim për përmbarrim ka dorëzuar edhe provën që dëshmohet se fatura është dorëzuar përmes postës

elektronike tek Debitori. Shton se Debitori sipas legjislacionit në fuqi kishte jo më shumë se 30 ditë kohë që të paguaj çmimin e faturës të cilën nuk e ka bërë deri më tani. Në këtë drejtim ka shtuar se Debitori nuk ka arritur t'i përmbahet kushteve të caktuara në faturë dhe kushteve të tjera që janë në fuqi, konsiderohet se i njëjti ka dal në vonesë. Përgjigjes në prapësim nuk ia ka bashkëngjitur asnjë provë, ka kërkuar shpërbllimin e shpenzimeve procedurale lidhur me përpilimin e përgjigjes në prapësim sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.383/2023, të datës 29.12.2023, e ka pranuar në tërësi prapësimi i debitorit “Euro Abi” ShPK me NUI 810677338 dhe seli në Viti, anulohet në tërësi urdhri përmbartimor P.nr.28/2023 i datës 10.01.2023 i përmbartuesit privat Bardh Tasholli me seli në Ferizaj dhe përfundohet në tërësi procedura përmbartimore. Ndërsa në piken II të dispozitivit është detyruar kreditorit i përmbartimit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t'ia paguaj debitorit të përmbartimit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas prapësimit të debitorit në shumë të përgjithshme prej 325.00€, në emër të përpilimit të prapësimit nga avokati, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara me nenin 182 par.2 të LPK-së, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sa i përket pretendimeve për zbatimin e gabuar të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka përfunduar në tërësi përmbartimin në këtë çështje përmbartimorë. Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se dokumenti i besueshëm-fatura, në bazë të cilit organi përmbartues ka caktuar përmbartimin, nuk i plotësojnë tiparet e përmbartueshmërisë.

Me Nenin Sipas nenit 29 par.1 Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP) është përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumta dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar “ ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën 3 paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Prandaj në këtë rast nga shkresat e lëndës rezulton se dokumenti fatura në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, me arsyetimin se fatura lëndore nuk është pranuar nga Debitori, meqenëse në atë nuk gjendet as nënshkrimi e

as vula e Debitorit, si dhe nuk ka prova se ai e ka pranuar faturën lëndore dhe detyrimin që rrjedh nga ajo, rrjedhimisht fatura lëndore rezulton të jetë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga Kreditorit, dhe si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbarrim. Si rezultat i mos pranimit kësaj fature, vjen deri te mungesa e tipareve të përmbarrueshmërisë së dokumentit të besueshëm, rrjedhimisht duhet të zbatohet neni 71 para. 1 nënpara. 1.1 të LPP-së, sipas të cilit “ *prapësimi mund të bazohen vetëm nëse dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarrues ose urdhri përmbarrues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë*”. Prandaj, mungesa e lartcekura në dokumentin e besueshëm paraqet pengesë të pakapërcyeshme ligjore, rrjedhimisht nuk mund të lejohet përmbarrimi, andaj, Kjo gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur e ka anuluar Urdhrin përmbarrimor si dhe kur e ka përfunduar procedurën si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin me arsyet se urdhri për përmbarrim është lejuar mbi bazën e faturës të cilat jo vetëm se nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, por faturës lëndore i mungon nënshkrimi dhe vula e debitorit.

Po ashtu, Kjo gjykate i vlerëson edhe pretendimet e kreditorit se fatura është dorëzuara përmes postës elektronike dhe nuk është kundërshtuar, mirëpo nga shkresat e lëndës nuk ka prova se fatura i është dërguar debitorit me postë elektronike ose palët kanë marrëveshje që fatura t’i dërgohen përmes e-mailit, prandaj këto pretendime i vlerësoi si të pabazuar këtë pretendim.

Kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret fatura kontestuese, si dokumente nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, pasi që është lëshuar në mënyrë të njëanshme, dhe nuk përmbanë nënshkrimin e pranuesit-debitorit. Që fatura të konsiderohet si pranimit i rregullt, do të duhej që debitori si palë kontraktuese, apo përfitues i shërbimeve ta pranonte faturën e rregullt me vënien e nënshkrimit nga personi përgjegjës apo i autorizuar ose vulën nga debitori. Së këndejmi, Gjykata gjen se urdhri për përmbarrim i caktuar nga përmbarruesi privat është lëshuar në bazë të një propozimi për përmbarrim i cili nuk i ka plotësuar kushtet që kërkohen me Nenin 38 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE
Dhomat e shkallës së dytë
K.Dh.Shk.II.nr.599/24, me datë 22.05.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi